

URDHËR
Nr. 117, datë 5.3.2021

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË VULËS, DOKUMENTIT
TË IDENTIFIKIMIT DHE TË PLUMBIT TË SEKUESTRIMIT PËRMBARIMOR TË
PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të nenit 44, pika 5, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së vulës të përmbaruesit gjyqësor privat, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
 2. Miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësor privat, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
 3. Miratimin e formës së plumbit të sekuestrimit përmbarimor të përmbaruesit gjyqësor privat, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
 4. Dokumenti i identifikimit përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj dhe paraqitet në çdo rast të ushtrimit të detyrës nga përmbaruesi gjyqësor privat. Përmbaruesi gjyqësor privat nuk mund të kryejë veprime procedurale pa qenë i pajisur me dokumentin identifikues.
 5. Plumbi i sekuestrimit përmbarimor vendoset nga përmbaruesi gjyqësor privat vetëm në sendet e luajtshme apo të paluajtshme, të cilat i sekuestron apo për të cilat kryen një veprim përmbarimor.
 6. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, me kërkesë të përmbaruesve gjyqësorë privatë, porositi dhe shpërndan dokumentin e identifikimit dhe plumbin e sekuestrimit përmbarimor.
 7. Tarifa për pajisjen me dokumentin e identifikimit dhe plumbin e sekuestrimit përmbarimor, që mbulon koston e prodhimit të tyre, caktohet nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, sipas rregullave të organizimit të brendshëm të kësaj dhome.
 8. Përmbaruesi gjyqësor privat i pezulluar, dorëzon dokumentin e identifikimit dhe plumbin e sekuestrimit përmbarimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, brenda pesë ditëve nga marrja e njoftimit të urdhrit përkatës.
 9. Dokumenti i identifikimit dhe plumbi i sekuestrimit arkivohen në dosjen personale të përmbaruesit me shënimin përkatës dhe i kthehet përmbaruesit vetëm më riaktivizimin e veprimtarisë përmbarimore, sipas legjislacionit në fuqi.
 10. Procesi i dorëzimit, arkivimit apo përkatësisht rikthimit pasqyrohet në procesverbalin përkatës që mbahet nga strukturat përgjegjëse për monitorimin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat në Ministrinë e Drejtësisë.
 11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privatë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
 12. Ngarkohet sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

SHTOJCË NR. 1
FORMA DHE PËRMBAJTJA E VULËS SË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

Vula e përmbaruesit gjyqësor privat ka formë rrethore dhe diametër 33 centimetra. Në qendër vendoset stema dhe rreth saj shkruhet “Republika e Shqipërisë”, në vijim shënim: “Përmbarues gjyqësor privat”, emri, shkronja e parë e emrit të babait, mbiemri i përmbaruesit.



SHTOJCË NR. 2
FORMA E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

Dokumenti i identifikimit të përmbaruesit ka formë drejtkëndëshe, me përmasa 8.5 cm x 5.5 cm. Me sfond të bardhë e germa të zeza.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT (<i>EMËRTIMI I SUBJEKTIT</i>) (<i>EMËR MBIEMËR</i>)
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

- Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbim Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe në Shërbim Përmbarimor Gjyqësor Privat.
- Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbaruesit gjyqësorë në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë kërkohet ndihma e tyre.
- Ky dokument përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

MINISTRIA E DREJTËSISË

Emër, mbiemër, nr. licence X, NUIS Y0203040508Q

Adresa: _____

SHTOJCË NR. 3
FORMA E PLUMBIT TË SEKUESTRIMIT PËRMBARIMOR TË PËRMBARUESIT
GJYQËSOR PRIVAT

Kjo formë dhe model i plumbit të sekuestrimit përmbarimor me përmasa 90 mm x 44 mm, miratohet nga Ministria e Drejtësisë dhe prodhohet në numër të autorizuar nga subjekte shtetërore ose private, sipas kërkesave të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

